



Implemented by



Joint German-Danish "Support to Agriculture and Rural Economic Development of Disadvantaged Mountainous Areas" (SARED)

Tiranë, 7 korrik 2015

Firmosen 13 kontratat e para për përfituesit e projektit SARED

Në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, në kuadër të skemës së granteve të programit SARED të bashkëfinancuar nga Qeveria e Gjermanisë dhe qeveria e Danimarkës dhe zbatuar nga MBZHRAU dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), firmosen 13 kontratat e para me përfituesit e granteve për investime në ferma dhe në agropërpunim.

Përfituesit e drejtpërdrejtë janë aplikantët fitues nga zonat e thella rurale të Shqipërisë, nga gjashtë qarqet që mbështet projekti SARED: Shkodra, Kukësi, Dibra, Elbasani, Berati dhe Korça.

Ata do të investojnë në mekanizimin e fermave të tyre me fruta dhe arrorë dhe në pajisjet e përpunimit të qumështit të ripërtypësve të vegjël, duke synuar rritjen e prodhueshmërisë dhe cilësisë së produkteve, për të plotësuar kërkesat e tregut për të rritur përfitimet e tyre.

Nga përparësitë që ka skema e granteve janë edhe gratë dhe sipërmarrësit e rinj. Midis 13 përfituesve të parë që do firmosin sot, është edhe një grua nga rajoni i Elbasanit si dhe një sipërmarrës i ri nga rajoni i Shkodrës.

Thirrja e parë për aplikim u hap më 17 prill 2015 dhe deri më sot janë dorëzuar 41 aplikime me një volum investimesh prej 930,000 Euro, nga të cilat 604,000 Euro janë në formën e granteve për përfituesit. Nga totali prej 41 aplikantësh deri më tani, 5 janë gra (4 nga Korça dhe 1 nga Elbasani).

Sot nënshkruhen 13 kontratat e para me një vlerë investimi prej rreth 270,000,- Euro nga e cila rreth 180,000,- Euro fermeret dhe agropërpunuesit e përfitojnë si grant.

Përfituesit vijnë nga të 6 qarqet që mbulon programi SARED dhe investimet do të shkojnë në pjesën më të madhe në pemëtarë dhe në përpunimin e qumështit nga bagëtitë e imta.

Nga marrja e aplikimeve për grante dhe deri në momentin e firmosjes së kontratave, skuadra e programit ka arritur t'i përpunojë kontratat në më pak se 2 muaj, siç është parashikuar edhe në procedurat e aplikimit.

Thirrja e parë vazhdon të mbetet e hapur për aplikime deri më 31 korrik 2015!

Thirrja e dytë do të hapet më 1 shtator 2015 dhe do të vijojë për 5 muajt në vazhdim!

Udhëzuesi për aplikantët mund të merret në formën online nga faqja e internetit e MBZHRAU, www.bujgesia.gov.al

Fermerët janë të mirëpritur të aplikojnë në zyrat rajonale në Drejtoritë e Bujqësisë në të gjashtë rajonet.